



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë (MSH), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Shëndetësisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Ministria e Shëndetësisë në vitin 2021 (bazuar në vendim të qeverisë dhe planifikimit buxhetor) ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 835,372€ në kategori ekonomike jo adekuate;
- A2 Fatura në vlerë 13,743€ nuk ishte shpalosur në PFV-të e vitit 2021 si obligim i papaguar; dhe
- B1 Pasuritë ishin të nënvlerësuara për 247,757€, pasi që MSH nuk kishte menaxhuar pasuritë në përputhje me kërkesat e rregullores nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të MSH kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Theksimi i Çështjes

- 1 Ministria e Shëndetësisë në vitin 2021 ka paguar 11,283,459€ për shpenzimet që lidhen me menaxhimin e pandemisë COVID-19 nga Mjetet e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike dhe Pako Emergjente Fiskale. Nga kjo vlerë 1,243,040€ janë shpenzuar në kategorinë e pagave, 8,414,118€ në mallra dhe shërbime, 1,200,621€ në subvencione si dhe 425,680€ në investime kapitale.
- 2 Sipas shënimeve të shpalosura në PFV, nga Njësia e Bankës Botërore është bërë tejkallim i kredisë të Projekti i Shëndetësisë Kosovare (është tejkalluar vetëm një pozicion i kredisë e jo totali i kredisë) për 342,710€ kryesisht si pasojë e ndryshimit të kursit valutor. Ministria e Shëndetësisë ka bërë kërkesë te Ministria e Financave për bartje të këtyre shpenzimeve nga fondi i huamarrjes në fondin e buxhetit por kërkesa nuk është aprovuar pasi nuk ka pasur mjete të lira. Kjo çështje do të trajtohet në Raportin e Auditimit të Pasqyrave Financiare të Qeverisë.

Opinionin e auditimit nuk është modifikuar për shkak të këtyre çështjeve.

## Çështje tjetër

- 1 Kontrata për blerjen e vaksinave kundër Covid-19 me prodhuesin Pfizer ishte klasifikuar si dokument Sekret, për këtë arsye shpenzimet që lidhen me këtë kontratë nuk janë audituar.

## **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Shëndetësisë.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Ministrisë së Shëndetësisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Shëndetësisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj

atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Shëndetësisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Ministria në vitin 2021 ka shpenzuar 54% të buxhetit final ose 62,711,491€ me një ulje prej 9% në krahasim me vitin 2020. Në kontekst të sistemeve financiare fushat ku janë identifikuar mangësi më të theksuara ishin te shpenzimet dhe kanë të bëjnë me klasifikimin jo adekuat të shpenzimeve, kompensimin e pushimit të lehonisë, dhe menaxhimin e proceseve të prokurimit. Me tutje, pasuritë nuk ishin regjistruar siç kërkohet në regjistrat kontabël dhe si rezultat i gabimeve si dhe mos harmonizimit vjetor kemi nënvlerësim material të pasurive.

Kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe duke u zbatuar në mënyrë efektive përdërisa niveli i inkasimeve në fushën e të arkëtueshmeve kërkon një përmirësim të mëtejshëm.

Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime, prej tyre pesë (5) janë rekomandime të reja, dy (2) të përsëritura dhe dy (2) pjesërisht të përsëritura.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

### Çështja A1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

#### Gjetja

Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 - Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Ministria e Shëndetësisë në vitin 2021 (bazuar në vendimin e qeverisë dhe planifikimin buxhetor) ka paguar dhe regjistruar shpenzime në vlerë prej 835,372€ në kategori ekonomike jo adekuate, si në vijim:

- Shpenzimet në vlerë prej 424,446€ për stafin shëndetësor të angazhuar nga ministria për menaxhimin e pandemisë me Covid-19 ishin paguar nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve sipas vendimit të qeverisë, por që për nga natyra këto shpenzime i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime;
- Shpenzimet për furnizime me pajisje mjekësore dhe teste serologjike në vlerë 443,517€ ishin paguar nga kategoria e investimeve kapitale, (Projekti emergjent Covid-19 për Kosovën përmes klauzolës së investimeve të cilat ishin të planifikuara me ligj të buxhetit). Nga kjo pagesë pajisjet mjekësore që i përkasin investimeve kapitale ishin në vlerë 46,450€ kurse pjesa tjetër prej 397,067€ ka të bëjë kryesisht me furnizime me teste serologjike e që për nga natyra këto shpenzime i përkasin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve; dhe
- Pagesa për furnizim me tavolina laboratorike në vlerë 13,859€ ishte buxhetuar dhe paguar nga investimet kapitale ndërsa pagesa i përket pajisjeve nën 1,000€ dhe i takon kategorisë mallra dhe shërbime.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e ndarjes së mjeteve financiare në disa raste me vendim të Qeverisë, dhe në raste tjera me Ligj të Buxhetit. Duhet theksuar se kërkesat e MSH-së sa i përket shpenzimeve për stafin e anagzhuar ishin që mjetet të buxhetohen dhe alokohen në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.

#### Ndikimi

Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të Ministrisë, duke mbivlerësuar/ nënvlerësuar kategoritë ekonomike përkatëse.

#### Rekomandimi A1

Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël. Një bashkëpunim më efektiv me Ministrinë e Financave do të lehtësonte gjetjen e zgjidhjeve, në mënyrë që të shmangen këto devijime.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)



**Çështja A2 - Nënvlërësim i obligimeve në PFV****Gjetja**

Sipas nenit 17.3 të Rregullores MF nr.01/2017 për Raportim Financiar Vjetor, "Organizatrat Buxhetore duhet t'i raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) për vitin raportues".

Gjatë testimit kemi vërejtur se shërbimet për faturën në vlerë 13,743€ ishin pranuar në fund të muajit gusht 2021, përderisa fatura ishte pranuar në fund të janarit 2022. Përkundër që fatura ishte pranuar para afatit për finalizim të PFV-ve, MSH nuk e kishte raportuar/shpalosur si obligimi i papaguar.

Arsyeja e mos raportimit të obligimit në PFV ishte mos komunikimi i duhur në mes drejtorive përkatëse, dhe vonesa e pranimit të faturës.

**Ndikimi**

Mos prezantimi i faturës së papaguar në kohën e duhur ka ndikuar në nënvlerësimin e obligimeve dhe rrjedhimisht edhe në prezantimin jo të saktë të tyre në PFV.

**Rekomandimi A2**

Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave një kordinim më efektiv në mes drejtorive në raportimin e faturave të papaguara me qëllim që në PFV të shpaloset vlera e saktë e obligimeve të papaguara.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B1 - Dobësi në regjistrin kontabël të pasurive****Gjetja**

Sipas nenit 6, pikës 3 të Rregullores MF - Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK, ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria". Kurse neni 5 i të njëjtës rregullore e përcakton klasifikimin që duhet aplikuar për regjistrimin e pasurive.

Nga testimet dhe analizat e regjistrit të pasurive kemi identifikuar se pasuritë e Ministrisë ishin të nënvlerësuara për 247,757€ (pasuritë të nënvlerësuara ishin për 269,816€ ndërsa të mbivlerësuara për 22,059€). Informatat detaje mund të shihen si në vijim:

- Nga pagesa furnizime me pajisje mjekësore dhe teste serologjike në vlerë 443,517€ është identifikuar se nuk janë regjistruar në SIMFK pajisje në vlerë 46,450€ si dhe nuk janë raportuar stoqet e mbetura në fund të vitit e që ishin në vlerë 223,366€;
- MSH kishte regjistruar gabimisht në SIMFK si investime në vijim 14 Pajisje mjekësore në vlerë 104,440€ e të cilat nuk ishin investime në vijim por pasuri finale. Pajisjet mjekësore ishin pranuar në muajin janar 2021 dhe si pasojë e regjistrimit të gabuar nuk ishte aplikuar zhvlerësimi. Kjo ka shkaktuar mbi vlerësim të pasurive në SIMFK në fund të vitit për 19,147€;
- Tetë (8) Loptop në vlerë 8,960€ të pranuar në korrik 2021 ishin regjistruar gabimisht si pajisje tjera përderisa është dashur të regjistrohen si kompjuterë. Kjo ka ndikuar në aplikim të normave jo adekuate të zhvlerësimit dhe si pasojë kemi mbi vlerësim të pasurive në SIMFK për 306€;

- Një pajisje e teknologjisë informative (scanner) në vlerë 2,606€ ishte regjistruar dy herë (te pasuritë mbi 1,000 edhe te pasuritë nën 1,000) duke shkaktuar mbi vlerësim të pasurisë në PFV për 2,606€; dhe
- Pasuritë në vlerë neto 291,493€ (Kompjuter zero client, monitor zero client dhe router) janë regjistruar dhe raportuar në PFV si pasuri nën 1,000€ përderisa këto pasuri i përkasin pasurive mbi 1,000€ pasi kanë të bëjnë me pagesa për projektin e Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH). Problemet kontraktuale që ndërliken me mirëmbajtjen e sistemin e-Pasuria nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme e kanë pamundësuar korrigjimin e gabimeve në këtë sistem.

Dobësitë në regjistrin kontabël të pasurive kanë ndodhur për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme, për sa i përket fushës së pasurisë dhe mos komunikimit të duhur në mes të njërive në kuadër të MSH-së, si dhe mos funksionimit të sistemit E-pasuria.

#### **Ndikimi**

Mungesa e regjistrave të saktë dhe të plotë të pasurive dhe raportimi jo i duhur i tyre pamundëson një menaxhim dhe kontroll efektiv mbi pasuritë. Si rrjedhojë e këtyre mangësive kemi nën nënvlerësim të pasurive duke rezultuar edhe në prezantimin jo të drejtë të tyre në pasqyra financiare.

#### **Rekomandimi B1**

Ministri duhet të sigurojë se të gjitha njësitë brenda MSH-së bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarin e pasurisë në mënyrë që të ketë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurive. Po ashtu, duhet shtuar kujdesi gjatë procesit të regjistrimit të pasurive dhe gabimet e evidentuara në regjistrin e pasurive duhet të korrigjohen në mënyrë që vlera e pasurive të jetë reale.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 11,526,220€ i cili ishte realizuar 100%. Në fund të vitit ishin 1,175 pozita aktuale të të punësuarve duke përfshirë edhe 18 zyrtarë të rinjë të punësuar gjatë vitit 2021.

#### Çështja A3 - Kompensimi i pushimit të lehonisë në kundërshtim me ligjin e punës

**Gjetja** Sipas nenit 49.3 të Ligjit të Punës nr.03/L-2012, Pushimi i lehonisë - përcaktohet se: Gjashtë (6) muajt e parë të pushimit të lehonisë pagesa bëhet nga punëdhënësi me kompenzim 70% të pagës bazë.

Në një rast kemi identifikuar se Ministria kishte bërë kompenzim në shumën totale të pagës bazë duke mos aplikuar ndalesën e pushimit të lehonisë, ndalesën e shujtës dhe shtesës për covid 19. Vlera bruto e pagesës për periudhën sa ka qenë në pushim të lehonisë ishte 3,811€, ndërsa vlera që duhej paguar ishte 1,980€. Shuma e tejkualuar është prej 1,831€.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i numrit të madh të specializantëve dhe mungesës së kontrolleve për specializantët nga ana e zyrtarëve përgjegjes të ministrisë.

**Ndikimi** Kompensimi i plotë i pagës së punonjësës, dhe dhënia e shtesave gjatë pushimit të lehonisë përveç që është tejkualim i kërkesave ligjore ndikon edhe në dëmtimin e buxhetit të Ministrisë.

**Rekomandimi A3** Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar monitorim të vazhdueshëm të punonjësve/specializantëve ashtu siç parashihet me aktet ligjore. Në rastet e tejkalimeve duhet të aplikohet ndalesa në pagë për të korigjuar dhe evituar dëmtimin e buxhetit për vlerën e tejkualuar.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2021 ishte 69,635,908€, prej tyre ishin shpenzuar 34,470,458€. Ato kryesisht kanë të bëjnë me shpenzimet për blerjen e barnave, mirëmbajtje dhe shpenzime tjera.

### Çështja A4 - Mos respektimi i kërkesave të ligjit të TVSH-së

#### Gjetja

Ligji Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), përkatësisht neni 46 përcakton se një person i tatueshëm i cili lëshon faturë për personat tjerë në rastin tonë për ministrinë, në faturë përveç tjerash duhet të shënojë shumën totale për pagesë duke e ndarë, vlerën e shitjes së mallrave apo shërbimeve pa TVSH, si dhe shumën e TVSH-së.

Ne identifikuam se në gjashtë fatura, që MSH kishte pranuar nga operator ekonomik (vlera e faturave 3,227,624€), nuk ishte ndarë vlera e TVSH-së, siç kërkohet me ligjin për TVSH-në, përderisa në kontratë kjo ndarje ishte bërë në çmimin e secilit artikull. Furnizimet kryesisht kishin të bënin me furnizime me material për testim për SARS COV-2 dhe furnizime me barna tjera.

Kjo kishte ndodhur në mungesë të kujdesit të duhur nga ana e zyrtarëve përgjegjës që pranimi dhe çertifikimi i faturës të jetë në përputhje me kontratën dhe kërkesat e ligjit mbi TVSH-në.

#### Ndikimi

Mos ndarja e TVSH-së nuk kishte efekt direkt financiar te MSH-ja, pasi që çmimi për artikuj në total ishte sipas kontratës por fakti që barnat kanë norma të përshkallëzuara të TVSH dhe mos prezantimi në faturë krijon konfuzion nëse të gjithë artikujt janë kontraktuar dhe faturuar me normën adekuate të TVSH-së.

#### Rekomandimi A4

Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave se çdo faturë e pranuar dhe e paguar nga ana e Ministrisë duhet të jetë në përputhje me kërkesat e ligjit të ATK-së. Po ashtu, Ministria duhet të rishikoj nëse normat e aplikuara të TVSH-së për këto fatura ishin adekuate dhe nëse ka devijime të ndërmerr veprime për korrigjimin e tyre.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.2.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 30,945,639€, prej tyre ishin shpenzuar 11,983,609€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin e objekteve shëndetësore, zgjerimin e infrastrukturës për Sistemin Informativ Shëndetësor, blerjen e pajisjeve mjekësore etj.

#### Çështja A5 - Vonesa në procesin e vlerësimit të tenderëve

##### Gjetja

Sipas nenit 41.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit për Prokurim Publik "Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të justifikuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh.

Në Procedurën e prokurimit "Furnizim me pajisje laboratorike" e cila ishte e përbërë nga tetë (8) lloje vlerësimi i ofertave ishte kryer 60 ditë pas hapjes së ofertave.

Vonesat kishin ndodhur për shkak të kompleksitetit të procedurës ku për disa pajisje kanë kërkuar sqarime shtesë nga OE.

##### Ndikimi

Vonesat në vlerësim të tenderëve përveç anashkalimit të rregullave kanë ndikuar edhe në vonesat në lidhje të kontratave e rrjedhimisht në shtyrjen e furnizimeve dhe marrjen e shërbimeve për qytetar.

##### Rekomandimi A5

Ministri duhet të sigurojë se vlerësimi i ofertave përfundohet brenda afateve të përcaktuara duke mundësuar që furnizimet të merren në kohën e paraparë. Në rastet kur bëhet fjalë për procedura komplekse duhet të shqyrtohen zgjidhjet e nevojshme për të përshpejtuar procesin e vlerësimit.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.4 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 13,274,554€, pasurive jokapitale është 2,847,990€, si dhe e stoqeve 6,798,837€.

### **Çështja B2 - Mos harmonizimi në mes raporteve të inventarizimit dhe regjistrave të pasurisë**

#### **Gjetja**

Sipas nenit 18.1 të Rregullores – Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, "Inventarizimi bëhet me qëllim të vërtetimit të saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurisë jo financiare".

Gjithashtu sipas nenit 24 të po të njëjtës rregullore "Pas barazimit të gjendjes me inventarizim dhe vlerësim me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare, gjendja e pasurisë jo financiare duhet të jetë pjesë e pasqyrave vjetore financiare në pajtim me rregullën financiare për pasqyrat vjetore financiare".

Ministria e Shëndetësisë dhe programet tjera në kuadër të ministrisë edhe pse kanë kryer inventarizimin, raportet e inventarizimit nuk janë harmonizuar/krahasuar me regjistrin e përgjithshëm të pasurisë, për të verifikuar saktësinë e informatave rreth pasurive.

Harmonizimi nuk është kryer për shkak të mos funksionimit adekuat të kontrolleve të brendshme, për sa i përket fushës së pasurisë si dhe mos funksionimit të sistemit E-pasuria.

#### **Ndikimi**

Harmonizimi i regjistrit të pasurive me inventarizim do të ndikonte direkt në identifikimin e pasurive të pa regjistruara dhe pasurive që mungojnë duke mundësuar azhurnimin e regjistrit me informata të sakta dhe të plota lidhur me pasurinë në posedim.

#### **Rekomandimi B2**

Ministri duhet të sigurojë se pas inventarizimit duhet të bëhet harmonizimi me regjistrin e pasurive për të korrigjuar gabimet e mundshme në regjistrin e pasurive.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2.5 Të arkëtueshmet

Ministria e Shëndetësisë kishte shpalosur në PFV, llogari të arkëtueshme (LI/A) në vlerë prej 879,462€, apo për 340,888€ më shumë se vitin paraprak. Kjo vlerë përbehet nga LI/A të prezantuara nga QKTGJK, IKSHPK, AKPPM, Inspektorati Shëndetësor dhe Farmaceutik.

### Çështja C1 - Mos arkëtimi i të hyrave në pajtim me Vendimin për gjobë nga Inspektorati Farmaceutik dhe Shëndetësor

**Gjetja** Paragrafi 2 i vendimeve nr.10/ND-103-21 dhe nr.10/JG-001-21 për gjobë nga Inspektorati Farmaceutik dhe Inspektorati Shëndetësor, përcakton që pagesa e gjobës duhet të bëhet në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Dy mostra të testuara në vlerë 9,000€ nga Inspektorati Farmaceutik dhe Shëndetësor nuk ishin arkëtuar gjordat brenda afatit prej tetë ditësh në pajtim me vendimin e lëshuar. Informatat detaje mund të shihen si në vijim:

- Gjoda në vlerë 8,000€ ishte lëshuar me datë 15.09.2021 nga Inspektorati Shëndetësor ndërsa pagesa nuk është kryer ende edhe përkundër skadimit të afatit tetë (8) ditësh; dhe
- Gjoda në vlerë 1,000€ ishte lëshuar me datë 22.01.2021 nga Inspektorati Farmaceutik ndërsa pagesa nuk është kryer ende edhe përkundër skadimit të afatit tetë (8) ditësh.

Në janar të vitit 2022 është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit mes Ministrit të Shëndetësisë dhe Kryetarit të Odës së Përmbauesëve Privat por deri në kohën sa kemi qenë në auditim (shkurt 2022) nuk ka filluar dërgimi i lëndëve tek përmbauesit.

**Ndikimi** Mos arkëtimi i të hyrave nga gjordat brenda afatit rezulton në arkëtimin e ulët të të hyrave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe si rezultat ndikon edhe në rritjen e borxheve dhe mosrealizimin e objektivave nga Inspektorati Farmaceutik dhe Shëndetësor.

**Rekomandimi C1** Ministri duhet të sigurojë që marrëveshja e arritur fillon të zbatohet dhe në të gjitha rastet kur inkasimi nuk kryhet në kohën e duhur lëndët duhet të procedohen te përmbauesi në mënyrë që të hyrat të inkasohen sa më parë.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.6 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) përbëhet nga drejtori dhe dy auditor. NJAB kishte hartuar planin vjetor të punës ku ishin planifikuar tetë (8) auditime të cilat edhe ishin realizuar gjatë vitit. Raportet e auditimit të brendshëm kishin rezultuar me 50 rekomandime. Prej tyre 25 rekomandime janë zbatuar, pesë (5) ishin në proces dhe 20 ende nuk janë zbatuar. Auditimet e planifikuara kishin fushëveprim kryesisht vitin 2020 dhe 2021 dhe kanë mbuluar auditime si Procedurat e prokurimit në IKSHKP, Procedurat e licencimit të Institucioneve Private Shëndetësore, Menaxhimi i pasurisë dhe menaxhimi me material zyrtar në MSH dhe QKTGJK, Pagesa e kujdestarive për mjek specializant dhe Shpenzimi i buxhetit sipas planit të keshit. NJAB kishte raportur në NJQH-AB duke përfshirë këtu realizimin e raporteve, numrin e rekomandimeve të dhëna si dhe sa prej tyre janë implementuar. Komiteti i Auditimit gjatë vitit kishte mbajtur vetëm një takim.

### Çështja C2 - Mos mbajtja e takimeve nga komiteti i auditimit

**Gjetja** Sipas nenit 8.1 UA 01/19 për Themelimin dhe Funksonimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik "Takimet e Komitetit të Auditimit mbahen së paku katër (4) herë në vit dhe ftohen nga kryesuesi i Komitetit të Auditimit".

Përkundër rekomandimit nga viti i kaluar, edhe këtë vit Komiteti i Auditimit në ministri nuk ka arritur të jetë funksional, meqenëse gjatë vitit ishte mbajtur vetëm një takim. Gjatë vitit ishin formuar dy komitete të auditimit. Komiteti i Auditimit i cili ishte formuar në qershor kishte mbajtur vetëm një takim, ndërsa komiteti i formuar me vendim në tetor nuk kishte arritur të mbante asnjë takim për vitin 2021.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e ndërrimeve në kabinetin e ministrit.

**Ndikimi** Mos mbajtja e takimeve nga Komiteti i Auditimit rrezikon pavarësinë e Njesisë së Auditimit nga ndërhyrjet e menaxherëve, si dhe mos- adresimin e duhur të rekomandimeve të dhëna nga NJAB.

**Rekomandimi C2** Ministri duhet të sigurojë se Komiteti i Auditimit mban takimet në mënyrë që puna e NJAB të monitorohet dhe të jetë e pavarur dhe efektive përmes zbatimit të rekomandimeve.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)



### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>4</sup>	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>97,182,643</b>	<b>117,023,432</b>	<b>62,711,491</b>	<b>51,357,239</b>	<b>26,153,128</b>
Grante Qeveritare – Buxheti	27,705,699	43,697,393	35,071,104	26,546,379	20,953,471
Financimi përmes huamarrjes	43,977,794	40,188,153	18,287,772	13,315,828	1,717,078
Financimi përmes huamarrjes – klauzola e investimeve	25,499,150	24,499,150	7,112,780	8,720,043	0
Të hyrat nga AKP-ja	0	0	0	1,348,237	3,260,449
Donacionet vendore	0	360,170	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	8,278,565	2,239,835	1,426,752	222,130

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 19,840,788€. Kjo rritje është rezultat i rritjes së buxhetit nga Granti Qeveritar si dhe nga donacionet.

Në vitin 2021 OB ka shpenzuar 54% të buxhetit përfundimtar ose 62,711,491€, me një ulje 9% në krahasim me vitin 2020. Sidoqoftë, zbatimi i buxhetit mbetet në një nivel të pakënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>97,182,643</b>	<b>117,023,432</b>	<b>62,711,491</b>	<b>51,357,239</b>	<b>26,153,128</b>
Pagat dhe mëditjet	7,707,582	11,526,220	11,508,451	8,222,716	7,436,352
Mallrat dhe shërbimet	54,348,758	69,412,004	34,270,481	27,097,654	10,175,832
Komunalitë	227,348	223,904	199,977	140,115	157,332
Subvencionet dhe transferet	2,813,805	4,915,665	4,748,974	1,731,449	1,929,033
Investimet Kapitale	32,085,150	30,945,639	11,983,609	14,165,306	6,454,579

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasur me buxhetin fillestar ishte rritur për 3,818,638€. Rritja ka ndodhur me rishikim të buxhetit prej 3,053,611€, përmes donacioneve prej 77,827€, përmes financimit nga huamarrja kishte rritje për 193,169€ si dhe me vendime të qeverisë për 494,031€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte pothuajse 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 15,063,246€. Ndryshimet kanë ndodhur me rishikim të buxhetit kishte rritje 14,978,616€, përmes donacioneve kishte rritje për 7,252,937€ dhe me vendime të qeverisë kishte zbritje për 7,168,307€. Niveli i ulët i shpenzimeve prej 49% i kësaj kategorie është për shkak se nga huamarrja është planifikuar blerja e vaksinave kundër Covid 19 ku sipas zyrtarëve të ministrisë është menduar që çmimi i vaksinave do të jetë shumë më i lartë mirëpo grupi për negociim të vaksinave ka arritur të negocion kontratë me çmim më të ulët atëherë pjesa më e madhe e kësaj kredie ka mbetur e pa shpenzuar;
- Buxheti final për komunalitë krahasur me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 3,444€. Ndryshimet kanë ndodhur me rishikim të buxhetit kishte rritje për 77,000€ si dhe me vendime të qeverisë zvogëlim për 80,444€;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 2,101,860€. Ndryshimet kanë ndodhur me rishikim të buxhetit kishte rritje për 2,803,741€ ndërsa me vendime të qeverisë kishte zvogëlim të buxhetit për 701,881€; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,139,511€. Ndryshimet kanë ndodhur me rishikim të buxhetit ku kishte zvogëlim për 496,000€, përmes donacioneve kishte rritje për 1,257,971€ ndërsa me vendime të qeverisë kishte zvogëlim të buxhetit për 1,901,482€. Niveli i ulët i shpenzimeve kapitale prej 39% ishte për shkak se me ligjin e buxhetit është ndarë projekti “Instrumenti për Financim të Sektorit Publik për Reagim Emergjent ndaj Covid-19” në vlerë 17,500,000€ dhe sipas zyrtarëve të ministrisë nuk ka pasur nevojë për shpenzim me ç’rast janë shpenzuar vetëm 1,548,858€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga Ministria e Shëndetësisë në vitin 2021 ishin në vlerë 5,301,986€. Të hyrat në MSH arkëtohen nga këto shërbime: gjobat nga inspektorati, licencat për aktivitete individuale dhe të lira, licencat për produkte medicinale, shitja e shërbimeve, participimet, banderolat dhe inspektimi sanitar.

Ministria nuk ka marrëveshje për shfrytëzimin e të hyrave të realizuara, por të gjitha arkëtimet e të hyrave derdhen në buxhetin e Kosovës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>5,183,880</b>	<b>4,962,957</b>	<b>5,301,986</b>	<b>4,197,908</b>	<b>4,962,172</b>
Të hyrat jo tatimore	5,183,880	4,962,957	5,296,048	4,195,412	4,868,318
Të hyrat tjera	0	0	5,937	2,496	93,854

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të Ministrisë së Shëndetësisë ka rezultuar në nëntë (9) rekomandime. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Ministria ka dorëzuar Raportet e Progresit mbi zbatimin e rekomandimeve sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, katër (4) rekomandime janë zbatuar; dy (2) ishin në proces dhe dy (2) nuk janë zbatuar ende, përderisa një (1) nuk është i aplikueshëm më siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se të gjitha njësitet bashkëpunojnë efektivisht me zyrtarët e pasurive që të ketë një regjistër të plotë dhe të saktë të pasurive.	Edhe gjatë këtij viti kemi hasur në dobësi në fushën e pasurisë. Shih B1	Nuk ka filluar zbatim
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave që kryhet rishikimi i plotë i të dhënave në lidhje me detyrimet kontingjente si dhe prezantimi i tyre në PFV të jetë në përputhje me informatat e sakta.	Janë ndërmarrë veprime dhe është implementuar rekomandimi	I zbatuar
3.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë se në rastet emergjente të shpenzimeve të përdorin procedurën e negociuar sipas Ligjit të Prokurimit. Ndërsa në rastet kur shpenzimet nuk i përkasin Ministrisë të prapësohen lëndët.	Nuk kemi hasur në raste të tilla	I zbatuar
4.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë se është kryer inventarizimi i pasurisë si dhe pas inventarizimit duhet të bëhet harmonizimi me regjistrin e pasurive për të korrigjuar gabimet e mundshme në regjistrin e pasurive.	Edhe këtë vit nuk është bërë harmonizimi në mes raporteve të inventarizimit dhe regjistrave të pasurisë. Shih B2	Nuk ka filluar zbatim
5.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë që përdorimi i procedurës së negociuar pa publikim të bëhet vetëm për rastet emergjente ndërsa shpallja e tenderit për projekte kapitale të bëhet sipas afateve të parapara në Ligjin e Buxhetit.	Nuk kemi hasur në raste të tilla.	I zbatuar
6.	Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë që të bëhet planifikimi i duhur në mënyrë që shpërndarja e barnave kryhet para skadimit të afatit të tyre.	Sasia e barnave me afat të skaduar është zvogëluar në masë të dukshme dhe pritjet janë që kjo sasi të mbahet në minimumin e mundshëm por jo të eliminohet krejtësisht. Në vitin tjetër do të monitorohet nëse do të ketë rritje substanciale.	Nuk është i aplikueshëm më
7.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri duhet të sigurojë përmes menaxherit të financave se konsolidimi i të dhënave nga agjencionet i nënshtrohet një rishikimi të plotë të saktësisë së të dhënave dhe gabimet parandalohen me qëllim që prezantimi i llogarive të	Nuk kemi hasur në raste të tilla	I zbatuar

		arkëtueshme të jetë i saktë në PFV.		
8.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri duhet të sigurojë një mekanizëm detyruës për implementimin e vendimeve të lëshuara për gjambat e inspektoratit farmaceutik.	Ministria ka marr veprime duke nënshkruar marrëveshje me oden e përmbaruesëve mirëpo ende nuk ka filluar dërgimi i lëndeve tek përmbaruesit. Shih C1	Pjesërisht i zbatuar
9.	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të sigurojë se Komiteti i Auditimit mban takimet në mënyrë që puna e NJAB të monitorohet dhe të jetë e pavarur dhe efektive përmes zbatimit të rekomandimeve.	Edhe këtë vit komiteti i auditimit nuk ka arritur të jetë funksional. Shih C2	Pjesërisht i zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Alban Beka, Udhëheqës i ekipit



Albesa Tolaj, Anëtare e ekipit



Leonora Hasani, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria-Vlada-Government*  
*Ministria e Shëndetësisë*  
*Ministarstvo Zdravlja - Ministry of Health*

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Ministrisë së Shëndetësisë**, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.



Dr. Rifat Latifi  
Ministër i Shëndetësisë  
Data: 25 maj 2022



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>5</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>6</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

**(shkëputur nga SNISA 200)**

### **Forma e opinionit**

#### **Opinionit i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

**Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit**

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

**Opinionit i kualifikuar**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

**Opinionit i kundërt**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>5</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.